



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 8 nëntor 2016
Nr. ref.:RK1000/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastet nr. KI61/16, KI65/16 dhe KI66/16

Parashtrues

**Omer Duraki
Ismet Pačka
Ismailj Ajdari**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet në Lidhje me
Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0213-A0006, të 28 janarit
2016**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Omer Duraki (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i parë), Ismet Pačka (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i dytë) dhe Ismailj Ajdari (në tekstin e mëtejme: parashtruesi tretë), të gjithë nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-13-0213-A0006, të 28 janarit 2016 (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), në lidhje me Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, SCEL-09-009 (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar), të 12 nëntorit 2013, dhe përgjigjen e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, SCEL-09-009-C0028 (në tekstin e mëtejme: AKP), të 15 majit 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit, AC-I-13-0213-A0006, të 28 janarit 2016 në lidhje me Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar, SCEL-09-009, të 12 nëntorit 2013 dhe përgjigjen e AKP-së, SCEL-09-009-C0028, të 15 majit 2012.
4. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkeljen e neneve 5 [Gjuhët], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike] dhe 59 [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: Konventa) dhe nenet 10 dhe 11 të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (në tekstin e mëtejme: Konventa për pakicat kombëtare) dhe nenet 6 dhe 11 të Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare (në tekstin e mëtejme: Karta Evropiane për gjuhët minoritare).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullat 37 (1) dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 5 prill 2016, parashtruesi i parë Omer Duraki e dorëzoi kërkesën me postë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), të cilën Gjykata e regjistroi më 12 prill 2016 nën numrin KI61/16.
7. Më 11 maj 2016, në kërkesën KI61/16, Kryetarja caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 12 prill 2016, parashtruesi i dytë Ismet Pačka e dorëzoi kërkesën me postë në Gjykatë, e cila më 14 prill 2016 u regjistrua nën numrin KI65 /16.

9. Më 11 maj 2016, në kërkesën KI65/16, Kryetarja caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Bekim Sejdiu.
10. Më 12 prill 2016, parashtruesi i tretë Ismail Ajdari e dorëzoi kërkesën me postë në Gjykatë, e cila më 18 prill 2016 u regjistrua nën numrin KI66/16.
11. Më 11 maj 2016, për kërkesën KI66/16, Kryetarja caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Selvete Gërxhalliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
12. Më 26 maj 2016 dhe më 28 qershor 2016, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe kopjet e tri kërkesave iu dërguan Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme) dhe AKP-së.
13. Më 18 korrik 2016, Kryetarja, në pajtim me rregullin 37 (1) të Rregullores së punës urdhëroi që kërkesa e parashtruesit të dytë Ismet Pačka KI65/16 dhe kërkesa e parashtruesit të tretë Ismail Ajdari KI66/16 të bashkohen me kërkesën e parashtruesit të parë Omer Duraki KI61/16.
14. Më 21 korrik 2016, Gjykata i njoftoi parashtruesit për bashkimin e kërkesave.
15. Pas procedurës për bashkimin e kërkesave, Kolegji shqyrtues përbëhej nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.
16. Më 15 shtator 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve në lidhje me parashtruesin e parë Omer Duraki KI61/16

17. Në bazë të dokumenteve të paraqitura, rezulton se parashtruesi i parë i kërkesës Omer Duraki ka qenë i punësuar në Ndërmarrjen Shoqërore "Hotel Theranda" në Prizren (në tekstin e mëtejme: NSH "Hotel Theranda").
18. Më 31 gusht 2006, NSH "Hotel Theranda" është privatizuar. AKP-ja ka publikuar listën preliminare të punëtorëve të cilët kanë të drejtë në 20% nga privatizimi i NSH-së "Hotel Theranda", në të cilën nuk ishte përfshirë parashtruesi i parë i kërkesës Omer Duraki.
19. AKP-ja ka publikuar listën përfundimtare të punëtorëve të cilët kishin të drejtë në pjesën e 20% nga privatizimi i NSH-së "Hotel Theranda". Lista përfundimtare është publikuar prej 21 deri më 24 maj 2009 në gazetatat ditore në gjuhën shqipe dhe serbe.
20. Më 18 prill 2012, parashtruesi i parë i kërkesës Omer Duraki paraqiti ankesë në Dhomën e Posaçme kundër vendimit të AKP-së, me të cilën kërkoj që të përfshihet në listën e punëtorëve të cilët kanë të drejtë për të marrë një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së "Hotel Theranda".

21. Më 16 maj 2012, AKP-ja u përgjigj në ankesën e parashtruesit, në të cilën theksoi: *“afati i fundit për parashtrimin e ankesës ka qenë 13.06.2009, derisa ankuesi e ka parashtruar ankesën më 18.04.2012, ankesa është parashtruar pas skadimit të afatit, dhe si pasojë ka propozuar që e njejta të hedhet poshtë si e papranueshme”*.
22. Më 12 nëntor 2013, Kolegji i Specializuar nxori Aktgjykimin SCEL-09-0009, me të cilin e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të papranueshme. Në arsyetimin e Aktgjykimit theksohet: *“Ankesa e parashtruesit është hedhur poshtë si e papranueshme, respektivisht e paraqitur pas afatit, me arsyetim se në bazë të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2008/6 në lidhje me nenin 10.6 (a) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, ankesa ndaj listës përfundimtare duhet të paraqitet brenda afatit prej 20 ditësh nga dita e publikimit të listës përfundimtare”*.
23. Më 29 nëntor 2013, parashtruesi i parë i kërkesës Omer Duraki parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit kundër Aktgjykimit SCEL-09-0009, të 12 nëntorit 2013, për shkak se, siç pohon *“për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe diskriminimit. Parashtruesi pretendon se Kolegji nuk e kishte marrë parasysh faktin se ai nuk ishte njoftuar për publikimin e listës përfundimtare, dhe për këtë arsye kërkon që aktgjykimi të ndryshohet dhe të përfshihet në listën e përfituesve të pjesës nga 20%”*.
24. Më 28 janar 2016, Kolegji i Apelit nxori Aktgjykimin AC-I-13-02130-A0006, me të cilin ankesën e parashtruesit të parë Omer Duraki e refuzoi si të pabazuar, me arsyetimin se *“Kolegji i Apelit vlerësoi se ankesa e parashtruesit është refuzuar me arsye si e papranueshme sepse ishte jashtë afatit”*.
25. Sa i përket pretendimeve lidhur me diskriminimin, Kolegji i Apelit theksoi: *“Ankuesi as në Kolegjin e Apelit nuk ka dorëzuar ndonjë fakt apo dëshmi shtesë për ta shpjeguar mënyrën e diskriminimit që do të justifikohet dhe që do të ndikonte që ai ta humb afatin”*.

Përmbledhja e fakteve në lidhje me kërkesën e parashtruesit të dytë Ismet Pačka KI65/16

26. Në bazë të dokumenteve të paraqitura, rezulton se parashtruesi i dytë i kërkesës Ismet Pačka ka qenë i punësuar në NSH-në “Hotel Theranda”.
27. Më 31 gusht 2006, NSH “Hotel Theranda” është privatizuar. AKP-ja ka publikuar listën preliminare të punëtorëve të cilët kanë të drejtë në pjesën e 20% nga privatizimi i NSH-së “Hotel Theranda”, në të cilën nuk ishte përfshirë parashtruesi i dytë i kërkesës Ismet Pačka.
28. Më 17 maj 2007, parashtruesi i dytë i kërkesës Ismet Pačka parashtroi kundërshtim ndaj listës preliminare, duke pretenduar, *inter alia*, se nuk ishte i përfshirë në atë listë në bazë të diskriminimit.

29. AKP-ja ka publikuar listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtë legjitime në pjesën e 20% nga privatizimi i NSH-së "Hotel Theranda". Lista përfundimtare është publikuar në gazetën ditore në gjuhën shqipe dhe serbe në periudhën prej 21 deri më 24 maj 2009.
30. Më 15 prill 2011, parashtruesi i dytë i kërkesës Ismet Pačka parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër listës përfundimtare të punëtorëve të publikuar nga AKP-ja.
31. Më 21 prill 2011, AKP-ja i dorëzoi Dhomës së Posaçme përgjigjen kundër ankesës së parashtruesit, duke pretenduar se *"në pajtim me nenin 10.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 ankesa është dashur të dorëzohet në Dhomën e Posaçme brenda 20 ditëve pas publikimit përfundimtar në media. Afati i fundit për paraqitjen e ankesës në Dhomën e Posaçme kundër listës përfundimtare ishte 13.06.2009"*.
32. Më 12 nëntor 2013, Kolegji i Specializuar me Aktgjykimin SCEL-09-0009 e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të dytë Ismet Pačka si të papranueshme.
33. Për sa i përket respektimit të afateve kohore për paraqitjen e ankesave dhe publikimit në gazetën ditore të listës përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime, Kolegji i Specializuar shpjegoi:

"Në bazë të nenit 67.6 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2008/06 në lidhje me nenin 10.6 (a) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, ankesa për listën përfundimtare duhet të parashtrohet në afat prej 20 ditësh prej datës së publikimit të listës përfundimtare."

Lista përfundimtare është publikuar në gazetën në gjuhën shqipe "Koha Ditore", "Kosova Sot", dhe "Infopress" më 21, 22, 23 dhe 24 maj 2009, derisa në gazetën në gjuhën serbe "Blic" është publikuar më 21, 23 dhe 24 maj 2009 dhe "Vijesti" më 22, 23 dhe 24 maj 2009.

Afati i fundit për parashtrim të ankesës në Dhomën e posaçme ka qenë 13.06 2009. Këto ankesa janë parashtruar pas skadimit të afatit.

Nga arsyet e mësipërme, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit".

34. Parashtruesi i dytë i kërkesës Ismet Pačka e parashtroi ankesën në Kolegjin e Apelit kundër aktgjykimit të lartpërmendur të Kolegjit të Specializuar. Parashtruesi i kërkesës u ankua kryesisht për vërtetimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, shkeljen e të drejtës materiale dhe diskriminimin mbi bazën e kombësisë.
35. Më 28 janar 2016, Kolegji i Apelit me Aktgjykimin AC-I-13-0213-A0006 e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar, dhe i mbështeti gjetjet e Kolegjit të Specializuar.

Përmbledhja e fakteve në lidhje me kërkesën e parashtruesit të tretë Ismail Ajdari KI66/16

36. Në bazë të dokumenteve të dorëzuara, parashtruesi i tretë Ismail Ajdari, ishte gjithashtu punëtor i NSH-së "Hotel Theranda".
37. Më 15 korrik 2009, parashtruesi i tretë i kërkesës Ismail Ajdari parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme, sepse AKP-ja nuk e ka përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve të cilët kanë të drejtë në pjesën e 20% të privatizimit.
38. Parashtruesi i tretë i kërkesës Ismail Ajdari në ankesë theksoi *"se afatin e ka lëshuar sepse nuk ka mundur të jetë i informuar për shkak të mungesës së sinjaleve televizive në fshatin ku jeton"*.
39. AKP-ja dërgoi në Dhomën e Posaçme përgjigjen ndaj ankesës së parashtruesit, duke pretenduar *"se parashtruesi e ka paraqitur ankesën kundër listës përfundimtare pas skadimit të afatit të përcaktuar me ligj, i cili është i përcaktuar me nenin 10.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, sipas të cilit ankesa duhet të paraqitet në Dhomën e Posaçme brenda 20 ditëve pas publikimit përfundimtar në media. Afati i fundit për paraqitjen e një ankese në Dhomën e Posaçme kundër listës përfundimtare ishte 13.06.2009"*.
40. Më 12 nëntor 2013, Kolegji i Specializuar me Aktgjykimin SCEL-09-0009 e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të tretë Ismail Ajdari si të papranueshme, për shkak se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor.
41. Brenda afatit ligjor, parashtruesi i tretë Ismail Ajdari parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit kundër aktgjyimit të Kolegjit të Specializuar.
42. Më 28 janar 2016, Kolegji i Apelit, me Aktgjykimin AC-I-13-0213-A0006, e refuzoi ankesën e parashtruesit të tretë Ismail Ajdari si të pabazuar, dhe i mbështeti gjetjet e Kolegjit të Specializuar.
43. Në arsyetimin e vendimit të Kolegjit të Apelit thuhet: *"Ankuesi as në Dhomën e Posaçme nuk ka paraqitur prova të vlefshme për të justifikuar pretendimet e tij për lëshimin e afatit për ankesë ndaj listës përfundimtare të punëtorëve, dhe për këtë arsye, Kolegji i Apelit konsideron se vendimi i Kolegjit të Specializuar është plotësisht i drejt"*.

Dispozitat relevante ligjore

RREGULLORE NR. 2003/13

MBI TRANSFORMIMIN E SË DREJTËS PËR PËRDORIMIN E PRONËS SË PATUNDSHME NË PRONËSI SHOQËRORE

Neni 10

TË DREJTAT E TË PUNËSUARVE

10.6 Pas paraqitjes së kërkesës nga individ apo individët me të drejtë të cenuar, ankesa lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime, e përcaktuar nga Agjencia dhe shpërndarja e fondeve nga llogaria e garancimbajtjes e paraparë në paragrafin 10.5, i nënshtrohet shqyrtimit nga Dhoma e Posaçme, në pajtim me nenin 4.1 (g) të Rregullores 2002/13.

(a) Ankesa duhet të dorëzohet në Dhomën e Posaçme brenda 20 ditëve pas shpalljes përfundimtare në media nga Agjencia, në bazë të paragrafit 10.3, të listës së të punësuarve me të drejta legjitime. Dhoma e Posaçme shqyrton çfarëdo ankese në bazë të përparësisë dhe merr vendim për këto ankesa brenda 40 ditëve pas dorëzimit të tyre.

URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2008/6

PËR NDRYSHIMIN DHE ZËVENDËSIMIN E URDHËRESËS ADMINISTRATIVE TË UNMIK-ut NR. 2006/17, ZBATIMIN E RREGULLORES NR. 2002/13 PËR THEMELIMIN E DHOMËS SË POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT

Neni 67

Ankesat lidhur me listën e punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën

67.6 A Ankesa e bërë në pajtim me nenin 10.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 para Dhomës së Posaçme bëhet me shkrim dhe përmban:

(a) Emrin ose emrat e personit ose të personave në emrin e të cilëve bëhet ankesa nga ("ankuesi(t)");

(b) Adresën e secilit ankues për dërgim;

(c) Bazat e detajuara ligjore dhe faktike ku mbështetet kërkesa për përfshirje ose kundërshtim të listës së punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën, të krijuar nga Agjencia apo shpërndarjen e fondeve nga llogaria garancimbajtëse e paraparë me nenin 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

44. Pretendimet e të tre parashtruesve të kërkesës janë krejtësisht identike, dhe si të tilla, Gjykata do t'i cekë në këtë raport.
45. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të neneve 5 [Gjuhët], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike] dhe 59 [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës, nenet 10 dhe 11 të Konventës për pakicat kombëtare dhe nenet 6 dhe 11 të Kartës Evropiane për gjuhët minoritare.
46. Sa i përket ankesave në AKP, parashtruesit e kërkesës pretendojnë:

"Me parashtruesin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, të dt. 26.03.2012, parashtruesit janë njoftuar se Agjencia tashmë e kishte publikuar listën përfundimtare më dt. 13.06.2009 dhe se ata nuk gjenden në atë listë. Në bazë të asaj që u tha, parashtruesit konsiderojnë se duhet të njoftohen personalisht nga Agjencia, gjë që nuk është bërë në këtë rast. Ndër të tjera, parashtruesit kanë theksuar se kanë qenë në marrëdhënie të punës në

NSH "Theranda" nga Prizreni deri në privatizim. Pas luftës ishin aktivizuar dhe kanë qenë në listën e pagave. Pas kësaj, nga udhëheqësia e atëhershme u është thënë se do të ftohen në punë. Ata kanë shkuar dhe janë lajmëruar çdo ditë në ndërmarrje dhe kanë kërkuar të angazhohen në punë. Me asnjë vendim të organit kompetent nuk u është ndërprerë marrëdhënia e punës në "Therandë" dhe nuk u është mbyllur përvoja e punës në librezën e punës".

47. Sa i përket shkeljes se nenit 5 [Gjuhët] të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës pretendojnë:

"Parashtruesit janë pjesëtarët e komunitetit boshnjak (GORAN), gjuha amtare e të cilëve është ekskluzivisht gjuha serbe, ndërsa shtypi i përditshëm është në gjuhën shqipe "Koha Ditore", "Kosova Sot" dhe "Infopress" gjuhë të cilën ata nuk e kuptojnë. Gazeta ditore në gjuhën serbe "Blic" dhe "Vijesti" janë gazeta që botohen në Republikën e Serbisë në të cilat qasja e ankuesve është e pamundshme. Nga sa u tha më sipër, parashtruesve u është dashur të informohen me shkrim për kërkesën e tyre të parë të 17 majit 2007, personalisht në gjuhën e tyre amtare, gjë që do t'i mundësonte parashtruesve që të njoftohen me kohë dhe të parashtrojnë ankesë në Dhomën e Posaçme. Pas skadimi të afatit për ankesë, parashtruesit kishin mësuar rastësisht nga disa kolegë të tyre për listën e publikuar dhe menjëherë kishin parashtruar ankesë në Dhomën e Posaçme, e cila u hodh poshtë si e paafatshme, që ishte rezultat i mos informimit të të njëjtëve".

48. Sa i përket shkeljes se nenit 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike] të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës pretendojnë:

"Me nenin 41 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës parashihet: "Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike" Në rastin në fjalë, parashtruesve në çdo formë u është mohuar e drejta e njëjtë pa marrë parasysh se dokumentacioni i tillë nuk e kishte karakterin e konfidencialitetit apo fshehtësisë, duke pasur parasysh të gjitha faktet e paraqitura më lart".

49. Sa i përket shkeljes së nenit 59 [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre] të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës pretendojnë:

"Me nenin 59 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës parashihet: "Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që, në mënyrë individuale ose si komunitet të kenë qasje të garantuar dhe përfaqësim të veçantë në mediet transmetuese publike".

Në rastin konkret parashtruesit nuk ishin informuar personalisht ose drejtpërdrejt në gjuhën amtare në lidhje me privatizimin dhe publikimin e listave".

50. Sa i përket shkeljes së nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës, parashtruesit e kërkesës pretendojnë:

“Në rastin konkret, gjykata me vendimet e saj nuk ka marrë parasysh gjatë vendosjes se atyre në procedurat paraprake me rastin e ushtrimit të të drejtave të tyre u janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore duke marrë parasysh faktet e mësipërme, përkatësisht parashtruesit në procedurë nuk ishin njoftuar fare apo nuk ishin informuar me kohë në gjuhën amtare.”

Pranueshmëria e kërkesës

51. Në mënyrë që të jetë në gjendje t'i gjykojë kërkesat e të tre parashtruesve, Gjkata së pari duhet të shqyrtojë nëse kërkesat KI61/16, KI65/16 dhe KI66/16 i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

52. Në këtë drejtim, Gjkata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

53. Gjkata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

54. Gjkata i referohet edhe rregullit 36 (2) (d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(2) Gjkata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

55. Gjkata merr parasysh edhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

56. Në këtë rast, Gjkata thekson se diskriminimi do të thotë trajtim ndryshe, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të personave në situata të ngjashme (shih, *Willis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 36042/97, § 48, GJEDNJ 2002- IV).

57. Gjkata, gjithashtu, ka gjetur se dallimi në trajtim që bazohet ekskluzivisht ose deri në një shkallë deçizive mbi origjinën etnike të personit nuk mund të justifikohet objektivisht në një shoqëri demokratike bashkëkohore të ndërtuar

mbi parimet e pluralizmit dhe respektit për kulturat e ndryshme (Timishev kundër Rusisë, nr. 55762/00 dhe 55974/00, § 56, GJEDNJ 2005).

58. Sa i përket barrës së provuarit në këtë fushë, Gjykata konstatoi se kur parashtruesi e ka treguar një dallim në trajtim, atëherë autoritetet duhet të tregojnë se ai ishte i justifikuar (shih, ndër autoritete tjera: *Chassagnou dhe të tjerët kundër Francës* [DHM], nr. 25088/94, 28331/95 dhe 28443/95, §§ 91-92, GJEDNJ 1999 - III, dhe *Timishev*, i cituar në paragrafin e mësipërm, paragrafi 57).
59. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për diskriminim në bazë të kombësisë dhe gjuhës, Gjykata vëren se AKP-ja vërtetë e ka përmbushur obligimin e saj ligjor për të publikuar listën e punëtorëve të cilët kanë të drejtë në pjesën e 20% nga privatizimi i NSH-së "Hotel Theranda" në të dy gjuhët kushtetuese, përkatësisht, në gjuhën shqipe dhe serbe. Gjykata, gjithashtu, vëren se versionin shqip i listës është publikuar në gazetën ditore shqiptare, ndërsa versionin serb është publikuar në gazetën ditore serbe.
60. Gjykata, gjithashtu, vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se janë diskriminuar mbi baza kombëtare dhe gjuhësore, kryesisht për shkak se lista e punëtorëve në gjuhën serbe është publikuar në gazetën të cilat nuk shpërndahen në zonën ku ata jetojnë. Përveç kësaj, ata pretendojnë se pikërisht për shkak të këtij fakti ata nuk kanë mundur t'i paraqesin ankesat në kohë.
61. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës është dashur të tregojnë "kujdesin e duhur" për t'i mbrojtur të drejtat e tyre kushtetuese në pajtim me kriteret ligjore. Në kohën e tashme, ku qasja ndaj informacionit është lehtësuar në masë të madhe nëpërmjet mjeteve elektronike, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk mund të ankohen se vetëm për shkak se gazetat nuk arrijnë në zonën ku ata jetojnë të jetë një bazë e mirë për iniciimin e një pretendimi të vlefshëm për diskriminim në baza kombëtare dhe gjuhësore.
62. Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kanë përjetuar ndonjë "vështirësi", si rezultat i mungesës së gazetave në gjuhën e tyre amtare të shpërndara në zonat ku ata jetojnë.
63. Për më tepër në lidhje me këtë çështje, Gjykata dëshiron të theksojë se e drejta për mbrojtjen nga diskriminimi nuk është e pakufizuar dhe se në rastin e parashtruesve të kërkesës ata nuk kanë treguar se ishin trajtuar ndryshe pa "justifikim objektiv dhe të arsyeshëm".
64. Sa i përket pretendimit të parashtruesve të kërkesës që AKP-ja ka shkelur të drejtën e tyre për gjykim të drejtë, sepse nuk u ka dorëzuar informacione dhe, se gjykatat e rregullta nuk e kishin marrë parasysh këtë kur vendosën, Gjykata konsideron se asgjë nuk i ka penguar parashtruesit për të parashtruar ankesën në Dhomën e Posaçme; për më tepër, ata në të vërtetë paraqitën ankesat në Dhomën e Posaçme, por gjykatat ankesat e tyre i vlerësuan si të paafatshme.
65. Sa i përket procedurës në Kolegjin e Specializuar dhe Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kishin përfituar

nga procedura akuzatore, për shkak se ishin në gjendje të paraqesin argumentet që i kishin konsideruar të rëndësishme për rastet e tyre; megjithatë, ankesa e tyre është vlerësuar si e paafatshme. Prandaj, ata në mënyrë të vlefshme nuk mund të pretendojnë një shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë (shih, për shembull, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], parashtresa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 29).

66. Parashtruesit e kërkesës nuk kanë përcaktuar saktësisht asnjë bazë të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tyre për diskriminimin dhe shkeljen e të drejtës për një gjykim të drejtë, në pajtim me nenin 48 të Ligjit; në vend të kësaj, ata vetëm i cekin dhe i numërojnë dispozitat kushtetuese dhe instrumentet dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare që ofrojnë garanci për të drejtën për gjykim të drejtë dhe të ndalojnë diskriminimin mbi baza kombëtare dhe gjuhësore.
67. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit apo të ligjit që pretendohen të jenë bërë nga gjykatat e rregullta me rastin e vlerësimit të provave ose aplikimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria).
68. Në fakt, roli i gjykatave të rregullta është që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, § 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
69. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se, vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj, nuk mund të veprojnë si “gjykatë e shkallës së katërt” (Shih rastin *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu *mutatis mutandis* në rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
70. Fakti se parashtruesit e kërkesës nuk pajtohen me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë për të ngritur një kërkesë të argumentueshme për shkelje të dispozitave kushtetuese dhe marrëveshjeve e instrumenteve ndërkombëtare (shih, për shembull, rastin nr. KI125/11, *Shaban Gojnovci*, Aktvendim për papranueshmëri, të 28 majit 2012, paragrafi 28).
71. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk i kanë mbështetur pretendimet për shkeljen e të drejtave themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë. Faktet në këtë rast nuk tregojnë se Dhoma e Posaçme dhe AKP-ja kanë vepruar në kundërshtim me masat mbrojtëse procedurale të përcaktuara me Kushtetutë.
72. Në dritën e arsyeve të mësipërme, Gjykata konsideron që në baza kushtetuese, kërkesat janë qartazi të pabazuara dhe duhet të deklarohen të papranueshme,

siç përcaktohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, parashihet në nenin 48 të Ligjit dhe që specifikohet më tej në rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, më 15 shtator 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TUA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi